



Buletini

- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial**
- * **Aktivitetet për profesionet e tjera ligjore**
 - * **Aktivitetet tjera**

Mars 2020

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Mbrojtja gjyqësore në rastet e së drejtës së pronësisë, servituteve dhe pengimit të posedimit

Më 03-04 Mars 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në bashkëpunim me projektin e financiar nga BE-së “Mbështetje Kodit Civil Faza 2” organizoi trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore në rastet e së drejtës së pronësisë, servituteve dhe pengimit të posedimit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet.

Në ditën e parë të trajnimit u diskutuan autorizimet e së drejtës së pronësisë, pronësia dhe pasuria, karakteristikat e së drejtës së pronësisë, kufizimet e së drejtës së pronësisë, e drejta fqinjësore, imisionet, rëndësia e mbrojtjes e së drejtës së pronësisë, paditë për mbrojtjen e së drejtës pronësore, llojet e padive, padia e reivindikimit, padia publiciane, padia negatore, natyra posedimit, nocioni i posedimit, objekti i posedimit, elementet e posedimit, llojet e posedimit, fitimi dhe humbja e posedimit, mbrojtja e posedimit dhe kompetenca.

Në ditën e dytë u trajtuan afati për ekzekutim të detyrueshëm të vendimit, servituti si një e drejtë sendore mbi sendin e huaj, objekti i servitutit, subjektet e servitutit, ndarja e servituteve,

mënyrat e fitimit të servitutit, shuarja e servitutit, shuarja e servitutit sendor, shuarja e servitutit personal.

Gjatë trajnimit u potencua se në procedurën që zhvillohet për kontestet për shkak të pengim posedimit, si procedurë e posaçme kontestimore që është rregulluar me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata i jep mbrojtje gjyqësore personit të cilit i është marrë sendi nga posedimi apo të cilit i shkaktohen pengesa gjatë shfrytëzimit të tij. Me dispozitat ligjore të përmendura mundësohet rivendosja e shpejtë dhe efikase e gjendjes faktike të çrregulluar, ku shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit nga gjykata do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë.

Metodologjia e trajnimit ishte e kombinuar, u përdoren metodat interaktive të diskutimit dhe shtjellimit të rasteve, është punuar në grupe dhe janë zbërthyer rastet praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykatave Themelore të të gjitha regjioneve të Kosovës dhe Bashkëpunëtor Profesional.



Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik Regjioni Mitrovicë

Më 04 mars 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementuar nga CHECCHI and COMPANY kanë realizuar trajnimin me temë “Ndërmjetësimi, në aspektin Civil, Penal dhe Ekonomik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin, si dhe identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar: parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Po ashtu është diskutuar edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin: Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtor profesional dhe ndërmjetësues nga regjioni i Mitrovicës.



Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore

Më 10 mars 2020, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me GIZ – LARP, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të procedurave specifike tek rastet ku përfshihen kryerës të veprave penale me çrregullime mendore si dhe në kuptimin e kushteve lidhur me aftësinë e këtyre personave për t’iu nënshtruar gjykimit.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua: korniza ligjore vendore e cila rregullon këtë sferë, kushtet për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm. Në veçanti u diskutua trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit

shëndetësor dhe trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjithashtu, u shtjellua edhe zbatimi i ekzaminimit psikiatrik nga eksperti, qëllimi i këtij ekzaminimi dhe fazat e dhënies së urdhrin për ekzaminim psikiatrik me ç’ rast u potencua niveli jo i kënaqshëm i ekspertizave të përgatitura nga ekspertët. Vëmendje iu kushtua edhe paraburgimit dhe kushtet e veçanta që duhet plotësuar për të përcaktuar paraburgimin ndaj personave me çrregullime mendore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtor profesional nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik Regjioni Pejë

Më 11 mars 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementuar nga CHECCHI and COMPANY CONSULTING, realizuan trajnimin me temë “Ndërmjetësimi, ne aspektin Civile, Penale dhe Ekonomike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin, si dhe identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij trajnimi janë elaborua: parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Po ashtu është diskutuar edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Ky trajnim shërbeu si orientim për gjyqtarët dhe stafin tjetër të gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të kontesteve të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin: gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtor profesional dhe ndërmjetësues nga regjioni i Pejës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit mars është vazhduar me realizimin e trajnimit teorik dhe praktik sipas kalendarit trajnues. Në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar (8) sesione trajnuese nga moduli: Kodi i Procedurës Penale, Rendi juridik kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare.

Nga nën moduli “Kontrolli dhe konfiskimi” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohuritë e tyre rreth: Ligjit mbi kompetencat e zgjeruara të konfiskimit duke e elaboruar me raste studimore nga gjykatat vendore.

Në kuadër të nën modulit “KEDNJ” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të avancojnë njohuritë lidhur me: Neni 6.1, neni 6.2 dhe 6.3 të kësaj Konvente, e drejta për qasje në gjykatë, parimi i barazisë së mjeteve, vendime të arsyetuara dhe koha adekuate dhe lehtësitë e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes duke

trajtuar edhe rastet si: Lauz kundër Austrisë dhe Artico kundër Italisë.

Po ashtu prokurorët kanë realizuar dy (2) sesione nga nën moduli “Etikë profesionale” me ç’ rast janë trajtuar: Historia e kodeve të etikës, evolucioni historik dhe shkollat kryesore të filozofisë së etikës, kodi i etikës-instrument për garantimin e integritetin e gjykatësve/prokurorëve dhe instrument për disiplinimin e tyre dhe veprimtaritë gjyqësore dhe jo gjyqësore të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë si dhe gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (6) ditë të trajnimit praktikë në prokurori.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar gjenerata e (VIII).



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përmbushur duke realizuar aktivitetet si në vijim: gjithsej 8 sesione trajnuese janë realizuar nga modulet: Kodi i procedurës penale dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Në kuadër të nën modulit “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja lidhur me: Fjalën hyrëse, konsideratat strategjike dhe ato të ndërlidhura me dëshmi, kuptimin, rregullat dhe teknikat e marrjes së tërthortë në pyetje si dhe fjalën përfundimtare.

Nga nën moduli “Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku gjyqtarët patën rastin të trajtojnë: Shqyrtimin gjyqësorë, parakushtet, shtyrja, ndërprerja dhe koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, procesverbali dhe fillimi i shqyrtimit gjyqësorë dhe deklarimi i të akuzuarit.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik gjyqtarët kanë realizuar edhe dy (2) sesione nga nën moduli “Provat në procedurën penale” ku pjesëmarrësit avancuan njohuritë e tyre rreth: Rregullave të përgjithshme të provave dhe vlerësimit të tyre si dhe provën e deklarimit të të pandehurit dhe deklarimit të dëshmitarit gjatë procedurës penale.

Po ashtu në kuadër të trajnimit fillestarë në përmbushje të realizimit të trajnimeve praktike në kuadër të “Zhvillimit të shkathtësive gjyqësore” gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar një “Simulim për teknikat e marrjes në pyetje” në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Për këtë periudhë gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar (6) ditë trajnimi praktikë në gjykatat përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 37 gjyqtarë të sapo emëruar gjenerata (VII) ku 7 prej tyre janë të komunitetit serbë.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Sistemi gjyqësor, dhe prokurorial, struktura dhe kompetencat

Më 6 Mars 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) ka realizuar trajnimin me temë “Sistemi gjyqësor dhe prokurorial, strukturat dhe kompetencat”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me kompetencat, mandatin, planifikimin, organizimin kontrollin dhe kornizën ligjore për menaxhimin e administratës gjyqësore dhe asaj prokuroriale.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan zhvillimet aktuale rreth punës së KGJK-së dhe KPK-së vendimet më të rëndësishme të tyre, aktet normative kryesore dhe politikat e

ndryshme për administrimin e sistemeve. Gjithashtu u diskutuan sfidat në ushtrimin e mandatit të dy këshillave.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç’rast pjesëmarrësit patën rastin të bëjnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ nga të gjitha nivelet e gjykatave dhe prokurorive, gjegjësisht zyrtarët ligjor, referentët administrativ, si dhe zyrtarët për komunikim me mediat dhe publikun.



Aktivitetet tjera

Programi praktik i kandidatëve të ENM-së në Kosovë i organizuar nga Akademia e Drejtësisë



Me 03-13 Mars 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj programin e praktikës në institucionet gjyqësore në Kosovë për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës (ENM). Ky program është në kuadër të bashkëpunimit që Akademia e Drejtësisë e ka tash e disa vite me Shkollën e Magjistraturës përmes Ambasadës Francezë në Kosovë.

Në ditën e parë të programit praktik, kandidatet u mirëpritën në takim nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu dhe nga Koordinatorja e Programit znj.

Valmira Pefqeli, me ç'rast kandidatëve nga Shkolla e Magjistraturës së Francës (ENM) i'u prezantua organizimi dhe sistemi i programeve të Akademisë së Drejtësisë, sistemi gjyqësor në përgjithësi në Kosovë dhe u udhëzuan për vazhdimin e qëndrimit të tyre në institucionet përkatëse, varësisht prej temave të interesit të tyre.

Në kuadër të kësaj vizite, kandidatet e ENM-së ndoqën një seancë trajnimi në Programin Fillestar për prokurorët e sapoemëruar (gjenerata e VIII). Po ashtu u organizua takim me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, z. Kujtim Munishi, i cili i mirëpriti dhe shprehi gatishmërinë që të jetë institucion pritës për një javë të praktikës së tyre në zyrat e Prokurorisë Themelore të Prishtinës.



Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit për Drejtësinë Komerciale



Me 12 mars 2020, në kuadër të Akademisë së Drejtësisë në prezencën e gjyqtarëve nga departamenti ekonomike dhe divizioni fiskal i departamentit administrativ është elaboruar analiza e nevojave për trajnime në të drejtën komerciale për gjyqtarë dhe stafin administrativ nga Programi i USAID – Drejtësia Komerciale implementuar nga Checchi and Company Consulting.

Qëllimi i këtij prezantimi ishte analiza dhe gjetjet kryesore mbi nevojat për trajnime si dhe konfirmimi i gjetjeve dhe dakordimi për programin e trajnimit nga ana e gjyqtarëve të departamentit ekonomik dhe divizionit fiskal të departamentit administrativ si dhe stafit administrativ të gjykatës nga departamenti ekonomik.

Me rastin e prezantimit u vu në pah që programi i USAID-it është në mbështetje të


krijimit të Gjykatës Ekonomike dhe fuqizimit të gjyqtarëve dhe stafit të saj me theks të veçantë përmes zbatimit të programeve të trajnimit në kuadër të Akademisë së Drejtësisë. Më tej u prezantuan gjetjet kryesore duke vënë në pah trajnimet e bazuara në kompetenca, programet gjithëpërfshirëse me strukturë modulare, trajnimet e specializuara, metodologjinë e bazuar në raste si dhe trajnimi i trajnuesve.

Në vazhdim u tha që programi synon që përveç njohurive nga kompetenca profesionale për drejtësinë komerciale të ofrojë edhe njohuri edhe sa i përket shkrimit dhe arsyetimit ligjor, etikës dhe teknologjisë informative.

Pas prezantimit të kësaj analize nga ekspertët e projekti të USAID-it gjyqtarët pjesëmarrës shprehën gatishmërinë për të marrë pjesë në këto trajnime duke e konfirmuar domosdoshmërinë e ngritjes së kapaciteteve të tyre të gjyqtarëve aktual dhe nevojën për përgatitjen edhe të gjyqtarëve të rinj në këtë fushë.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin gjyqtarët dhe stafi administrativ departamenti ekonomik dhe divizioni fiskal i departamentit administrativ.





Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>